



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.03-158

11.04.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 14 të Ligjit për media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13 dhe 13/14), pika 10 e Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion për shfrytëzuesit, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje masë (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-1340/1 datë 23.3.2023 dhe Konkluzionin nr.02-1777/7 datë 10.4.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 13-të. mbajtur më 10.4.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 14 nga Ligji për media (LM), në mënyrë që transmetuesu në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar në 6 mars 2023, në edicionin e përsëritur të emisionit argëtues-informativ " 1 Kafe prej Sh'pisë (1 Кафе од куќата)", nuk ka publikuar të dhënat që është i detyruar t'i transmeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me Shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.10-1340/1 datë 23.3.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr.1.

2. URDHËROHET SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ta harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij konsiderohet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të LM, është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të veprimtarisë së botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së funksionimit të tyre me detyrimet e neneve 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer cenim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ kompetent rregullator mund t'i ndërmarë, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individual të përmbajtjes (për shembull mostër e medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave të mëposhtme: emrin dhe adresën e selisë dhe redaksive të botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, pra redaktorët në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin, adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, në rastin e një mediumi të shtypur. Për transmetuesit detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat të publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audi vizuale. Botuesi i medias është i detyruar të publikojë në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës së publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, gjegjësisht të shoqërisë që ka të drejtën e autorit për përmbajtjet e publikuara, përveç atyre të shtypura dhe programeve në radio, data e prodhimit (prodhimt) (muaji dhe viti) në rastin e një veprë audio/audi vizuale, origjinën e veprës audio/audi vizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga një prodhim i pavarur dhe informacione për të, emri i personi juridik, pra emri dhe mbiemri i personit që e ruan të mirën kulturore të përdorur ose veprën arkivore, përkatësisht riprodhimin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë shtojca (bashkëngjitja) e programit ose klipi nga bashkëngjitja e programit, përveç rasteve nëse është rregulluar ndryshe me marrëveshje të ndërsjellë.

Në bazë të pikës 10 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, kur transmetohen programe të prodhimit të huaj, radiodifuzeri duhet të transmetojë shpicën origjinale.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 23 mars 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj shërbimit programor televiziv të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, transmetuar më 6 mars 2023, nga ku u konstatua se në pjesë të programeve nuk janë publikuar të dhënat që identifikojnë autorët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjeve audiovizuale, për bartësin e të drejtës së autorit, redaktorin/redaktorët përgjegjës të programeve, origjinën dhe datën e prodhimit të veprave audiovizuale, emrin e mediumit nga i cili është shkarkuar përmbajtja etj., të cilin transmetuesi është i detyruar ta transmetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Në kundërshtim me pikën 10 të Udhëzimit për përmbushje të detyrimit për impresium dhe informacion në dispozicion për përdoruesit (kur transmetohen programe të prodhimit të huaj, televizioni duhet të transmetojë shpicën origjinale), në ripërsëritjen e emisionit argëtues-informativ " 1 Kafe përpara Sh'pisë (1 kaĝe од кyката)", nuk është publikuar të dhëna për impresium, pra nuk është transmetuar shpica origjinale e programeve.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-1340/1 datë 23.3.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr. 1 .

Në bazë të nenit 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, më datë 24.3.2023, dërgoi Shkresë Nr.y në ark.10-1340/ 2 datë 24.3.2023 . me të cilin dorëzoi Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr. 10-1340/1 datë 23.3.2023, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt më 24.3.2023. Në afatin e paraparë SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur në 10.4.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi se ndaj SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 të LM, pika 10 nga Udhëzimi për përmbushjen e detyrimit për impresium dhe informacion në dispozicion për shfrytëzuesit, ark.nr.01-4443 /1 datë 9.10.2018, pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-1340/1 datë 23.3.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1777/7, datë 10.4.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur me 10.4. 2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij

aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit. Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-1340/1 datë 23.3.2023 .

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.